

## **THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT TË GAZETARËVE PËR PJESËMARRJE NË TRAJNIMIN PËR NJOFTIM MBI PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN**

### **PËR PROJEKTIN**

Projekti "Mbështetje nordike për përparimin e Maqedonisë së Veriut" synon të përmirësojë kapacitetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për integrim në BE. Projekti financohet nga Mbretëria e Norvegjisë me 5,5 milion euro dhe Qeveria e Suedisë përmes Agjencisë Suedeze për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim (Sida) me 2,05 milion euro.

Projekti përforcon kapacitetet për anëtarësim në BE duke ofruar ndihmë teknike dhe duke ndërtuar kapacitetet e mekanizmit koordinues qeveritar për negociatat për anëtarësim. Projekti mbështet harmonizimin efektiv të legjislacionit kombëtar me të drejtën e BE-së dhe zbatimin e tij, dhe në të njëjtën kohë mundëson angazhimin e ekspertëve të duhur, si dhe shkëmbimin e përvojave dhe bashkëpunimin me shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e rajonit.

Në veçanti, projekti përforcon kapacitetet e Sekretariatit për çështje Evropiane (SÇE), duke marrë parasysh rolin udhëheqës në koordinimin, planifikimin, monitorimin dhe menaxhimin e negociatave të anëtarësimit në BE.

Projekti kontribuon në përmirësimin e komunikimit të procesit të anëtarësimit në BE, vlerave dhe përfitimeve të BE-së, mbështet qasjen e komunikimit strategjik dhe zbatimin e veprimeve prioritare, të cilat do të përmirësojnë mirëkuptimin dhe interesin e publikut për anëtarësimin në BE. Gjithashtu, përmes dhënies së granteve, projekti e bëri të mundur mbështetjen dhe përforcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile, mediave dhe të rinjve si dhe përfshirjen e tyre më të madhe në procesin e anëtarësimit.

Me mbështetjen e ofruar nga Qeveria e Suedisë, projekti deri tani ka realizuar dy cikle të trajnimeve për gazetarët, në nëntor të vitit 2020 dhe në nëntor të vitit 2022, me qëllim të

përforcimit të kapaciteteve të mediave në drejtim të krijimit të përmbajtjes mediatike për procesin e negociatave me BE-në.

## **TRAJNIM PËR NJOFTIM PËR PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN**

Projekti "Mbështetje nordike për përparimin e Maqedonisë së Veriut" shpall thirrje për përzgjedhjen e gazetarëve për pjesëmarrje në trajnime për tu njoftuar për procesin e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Me thirrjen kërkojmë që të aplikojnë gazetarët që janë qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët mbulojnë tema lidhur me procesin e anëtarësimit në BE, që të përfshihen në trajnimin njëditor i cili do të organizohet gjatë shkurtit të vitit 2023 në Shkup, i cili gjithashtu do të përfshijë udhëtimin dhe pjesëmarrjen në sesionet e skringut shpjegues të planifikuara nga 15-17 mars të vitit 2023 në Bruksel.

Qëllimi kryesor i trajnimit për gazetarë është fuqizimi i kapaciteteve të mediave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me njohuritë dhe raportimin për procesin e anëtarësimit në BE dhe të theksohet rëndësia e këtij procesi për qytetarët përmes informimit të balancuar, mbulimit të detajuar të procesit dhe ndarjen e informacioneve relevante dhe cilësore për publikun.

Ky trajnim do t'u mundësojë gazetarëve të njihen me:

- Detaje në lidhje me realizimin e procesit të skringut dhe realizimin praktik të negociatave
- Rolin e mediave në sigurimin e informacioneve cilësore dhe në kohë në lidhje me këtë proces
- Rëndësinë e transparencës në procesin e integritetit dhe sfidat e mundshme.
- Specifikat e njoftimit praktik nga sesionet e skringut shpjegues.

Trajnimi do të përfshijë një pjesë teorike që do të organizohet në Shkup në shkurt të vitit 2023, si dhe një pjesë praktike me udhëtim dhe pjesëmarrje në sesionet e skringut shpjegues për Kllasterin 4 - Agjenda e gjelbër dhe e qëndrueshme dhe lidhshmëria, që do të mbahet në Bruksel, në periudhën prej 15 deri më 17 mars të vitit 2023.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar dhe do të përcaktohet sipas mjeteve në dispozicion për këtë qëllim në kuadër të projektit.

Shpenzimet e pjesëmarrësve për udhëtimin në Bruksel do të mbulohen nga organizatori.

## **PËRZGJEDHJA E PJESËMARRËSVE**

Përzgjedhja e gazetarëve që do të marrin pjesë në trajnim do të bëhet sipas kriterëve të caktuara që janë relevante për qëllimin e trajnimit. Trajnimi është dizajnuar posaçërisht për gazetarët që kanë përvojë ose janë emëruar nga mediat e tyre për të raportuar mbi tema që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE.

Për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnim do të përdoren kriteret e mëposhtme:

- Përvoja e mëparshme profesionale e gazetarit në pasqyrimin e temave lidhur me procesin e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, si dhe tema të tjera politike, sociale dhe ekonomike. Përparësi në përzgjedhje do të kenë gazetarët me përvojë më relevante nga lemia.
- Interesimi i mediave për pasqyrimin e temave lidhur me procesin e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Përparësi në përzgjedhje do të kenë mediat me interes dhe mbulim më të madh të këtyre temave.
- Rëndësia e trajnimit për punën e ardhshme të gazetarit, e dorëzuar nga gazetari në formë të lirë në një paragraf të shkurtër gjatë dorëzimit të vetë aplikimit.
- Njohuri të gjuhës angleze dhe/ose të një gjuhe tjetër zyrtare të Bashkimit Evropian.

Projekti mban të drejtën të kërkojë informacione dhe dëshmi shtesë për të përmbushur kriteret e dhëna, si dhe të organizojë intervista të kandidatëve nese është e nevojshme.

Pas përzgjedhjes së bërë, gazetarët e përzgjedhur do të njoftohen për detajet për trajnimin në Shkup dhe në Bruksel.

## **MËNYRA DHE AFATET E DORËZIMIT TË APLIKIMEVE**

Që të aplikoni, dërgoni biografinë tuaj (CV), kopje ose link nga storjet/artikujt/intervistat tuaja të publikuara tashmë në lidhje me integrimin Evropian të Republikës së Maqedonisë së Veriut, një kopje ose link i storjeve/artikujve/intervistave të publikuara të medias në lidhje me integrimet evropiane, pëlqimi nga media juaj për të marrë pjesë në trajnim, një paragraf i shkurtër (jo më shumë nga 250 fjalë) në gjuhën maqedone, shqipe ose angleze se si ky trajnim do të mbështesë punën tuaj të ardhshme, si dhe informacione të tjera për të cilat mendoni se janë të rëndësishme për përmbushjen e kriterëve të rradhitura për përzgjedhje, në mënyrë elektronike në [ecr.rsoc.mkd-office@unops.org](mailto:ecr.rsoc.mkd-office@unops.org) me shënim: *Thirrje për shprehjen e interesit të gazetarëve për pjesëmarrje në trajnime për njoftimin për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian*. Afati i aplikimit është 6 shkurt i vitit 2023.

Të gjitha aplikimet e pranuar do të vlerësohen nga një komision vlerësues i përbërë nga përfaqësues të projektit Mbështetja nordike për përparimin e Maqedonisë së Veriut dhe Sekretariati për çështje Evropiane. Aplikantët që do të përfshihen në listën e ngushtë do të njoftohen sërish .

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me procesin e aplikimit, ju lutemi dërgoni ato në mënyrë elektronike në [ecr.rsoc.mkd-office@unops.org](mailto:ecr.rsoc.mkd-office@unops.org).

Trajnimi financohet nga Agjencia suedeze për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim (Sida), përmes projektit "Mbështetja nordike për përparimin e Maqedonisë së Veriut" të realizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për shërbime të projekteve (UNOPS) në partneritet me Sekretariatit për çështje evropiane.